



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1137/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Saladin Xhaferit anetare i LDK-se konkretisht kandidatë për asamble komunale të komunes së Prizrenit paraqitur kundër Qendres së Numrimit të Rezultateve (QNR) pas publikimit të rezultateve përfundimtare për kuvend komunal për shkak të parregullsive gjate procesit zgjedhor dhe Manipulimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Saladin Xhaferit kandidat për kuvend komunal të Prizrenit nga rradhet e LDK-se dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Saladin Xhaferi anetare i LDK -se konkretisht kandidat për asamble komunale të Komunes së Prizrenit në të cilën pretendon në manipulim të votave pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga QNR-ja duke mos i përfshirë të gjitha votat me kusht në rezultat përfundimtar për kandidatin në fjalë në qendrat e votimit 2013a(04) në Lubizhde të Prizrenit dhe në qendrën 2038(02d) ku kandidati në fjalë pretendon se ka disa dhjetra vota të cilat nuk janë përfshirë në rezultat përfundimtar, duke mos u renditur për disa vota si kandidat fitues në listen për asamble nga rradhet e LDK-se në Prizren. Në këto qendra të votimit mungojnë edhe votat e antareve të familjes që kanë votuar. Duhet cekur se sipas procesverbaleve që i ka numruar vet kandidati në fjalë në KKZ të Prizrenit votat e rregullta po dalin që janë 446 ndërsa votat me kusht nuk janë të përfshira askund pasi që shumica e votave janë zhvendosur nga vendvotimet paraprake, sa i përket votave të rregullta deshmimitar është përfaqësuesi i LDK-se në KKZ të Prizrenit. PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga deshmite e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se ka ndodhur manipulimi i votave gjate procesit zgjedhor, vlerësohen si të pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 1137/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*